



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 20 qershor 2025
Nr. Ref.: RK 2702/25

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI262/24

Parashtrues

Blerta Dalloshi-Berisha

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit [AKAP. II. nr. 194/24]
të 13 gushtit 2024 të Prokurorisë së Apelit**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Nexhmi Rexhepi, kryetar
Safet Hoxha, zëvendëskryetar
Bajram Ljatifi, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Blerta Dalloshi-Berisha, me vendbanim në Komunën e Prishtinës (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës konteston Aktvendimin [AKAP. II. nr. 194/2024] e 13 gushtit 2024, të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë (në tekstin e mëtejshëm: Prokuroria e Apelit).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit [AKAP. II. nr. 194/2024] të 13 gushtit 2024, të Prokurorisë së Apelit, përmes të cilit pretendohet se parashtrueses së kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të saj, të garantuara me nenet 27 [Ndalimi i Torturës, Trajtimin Mizor, Çnjerëzor ose Poshtëruar], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E drejta për mjete juridike] dhe 40 [Liria e Shprehjes] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), në ndërlidhje me nenet 3 (Ndalimi i Torturës), 6 (E drejta për një proces të rregullt), 10 (Liria e Shprehjes) dhe 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa Individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës nr. 01/2023 së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 16 dhjetor 2024, parashtruesja e kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).
6. Më 30 dhjetor 2024, bazuar në paragrafin 2 të rregullit 8 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës [KK-SP 812-1/24], të 10 dhjetorit 2024 të Gjykatës, gjyqtari Nexhmi Rexhepi mori detyrën e Kryetarit të Gjykatës, ndërsa bazuar në nënparagrafin 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Gresa Caka-Nimani përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese. Të njëjtën ditë, përkatësisht më 10 dhjetor 2024, përmes Vendimit të Gjykatës [KK-SP 812-2/24] gjyqtari Safet Hoxha u zgjodh Zëvendëskryetar i Gjykatës, dhe bazuar në paragrafin 2 të rregullit 8 (Zgjedhja e Kryetarit/es dhe e Zëvendëskryetarit/es) të Rregullores së punës dhe vendimit të lartcekur të Gjykatës u përcaktua që gjyqtari Safet Hoxha, detyrën e Zëvendëskryetarit e merr më 11 dhjetor 2024.
7. Në të njëjtën ditë, bazuar në nënparagrafin 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 të Ligjit, edhe gjyqtarja Selvete Gërzhaliu-Krasniqi përfundoi mandatin e gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.
8. Më 6 janar 2025, Kryetari i Gjykatës përmes Vendimit [nr. GJR. KI262/24] caktoi gjyqtarin Radomir Laban gjyqtar raportues, si dhe përmes Vendimit [nr. KSH. KI262/24] Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Nexhmi Rexhepi (kryesues), Enver Peci dhe Jeton Bytyqi (anëtarë).
9. Më 14 janar 2025, Gjykata e njoftoi parashtruesen e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Në të njëjtën ditë, Gjykata e njoftoi Prokurorinë e Apelit për regjistrimin e kërkesës së bashku me kopjen e kërkesës, lidhur me mundësinë e paraqitjes së

komenteve të tyre si dhe i kërkoi që t'ia dorëzojë kopjen e fletëkthesës e cila dëshmon se kur parashtruesja e kërkesës e ka pranuar vendimin e kontestuar.

10. Më 20 janar 2025, Prokuroria e Apelit ia dorëzoi Gjykatës dëshminë e dorëzimit të vendimit, por jo fletëkthesën e kërkuar e cila dëshmon datën e pranimi të vendimit nga ana e parashtrueses së kërkesës.
11. Më 4 qershor 2025, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Nga shkresat e lëndës rezulton se më 28 dhjetor 2023, parashtruesja e kërkesës, në cilësi të gazetares së akredituar, me ftesë të Qeverisë së Republikës së Kosovës, mori pjesë në *“Përrurimin e fillimit të punëve për rregullimin e rrjetit të ujësjellësit në Komunën e Fushë-Kosovës, në të cilën ngjarje pritej të merrnin pjesë Kryeministri së bashku me dy ministra dhe kryeshefin e KRU Prishtina”*. Sipas pohimeve të parashtrueses së kërkesës, para fillimit të ngjarjes, në tentativë të parashtrimit të një pyetje ndaj Kryeministrit, pasi i njëjti nuk ishte ndalur për t'u deklaruar, e njëjta ishte sulmuar nga mbrojtja e afërm e tij, përkatësisht nga zyrtari policor B.RR.
13. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesja e kërkesës denoncoi policin B.RR. në Inspektoratin Policor të Kosovës në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Inspektorati Policor), dhe të njëjtës i dorëzoi pamjet e filmuara të incidentit përmes CD-së, për shkak të dyshimit të kryerjes së veprës penale të lëndimit të lehtë trupor.
14. Më 27 mars 2024, Paneli disiplinor i Policisë së Kosovës, përmes raportit përfundimtar lidhur me veprimet e të dyshuarit B.RR, përkitazi me zhvillimin e hetimit, rekomandoi se *“gjatë hetimit disiplinor nuk është dëshmuar se është përdorur forcë e tepruar dhe se veprimi i zyrtarit policor ka qenë konform specifikave të punës për mbrojtjen e afërt”*.
15. Më 29 mars 2024, Policia e Kosovës përmes vendimit, e pushoi procedurën disiplinore ndaj të dyshuarit B.RR, me arsyetimin se i njëjti ka vepruar në përputhje me detyrat dhe specifikat e punës së Departamentit për Mbrojtjen e Afërt.
16. Më 14 qershor 2024, Inspektorati Policor paraqiti kallëzim penal në Prokurorinë Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Prokuroria Themelore) kundër të dyshuarit B.RR, si rezultat i denoncimit për dyshimin se i njëjti kishte kryer veprën penale *“Lëndim i lehtë trupor”* i paraparë me paragrafin 1 të nenit 185 (Lëndim i lehtë trupor) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme KPRK-së).
17. Nga shkresat e lëndës, në një datë të paspecifikuar rezulton se Prokurori i Shtetit, pas analizimit të provave, e ricilësoi çështjen penale të ngritur përmes kallëzimit penal, nga vepra penale *“Lëndim i lehtë trupor”* në veprën penale *“Keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike”*, i paraparë me paragrafin 1 të nenit 195 (Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike) të KPRK-së.
18. Më 8 korrik 2024, Prokurori i Shtetit, në kuadër të vlerësimit të dyshimit të bazuar, autorizoi Inspektoratin Policor për të marrë në pyetje kapitenin B.B, në cilësi të dëshmitarit, i cili po ashtu ishte i ngarkuar me detyrën e vlerësimit të sjelljeve të operatorëve të mbrojtjes së afërt.
19. Më 16 korrik 2024, Inspektorati Policor dorëzoi raportin e vlerësimit hetimor së bashku me procesverbalin e deklarimit të dëshmitarit.

20. Më 25 korrik 2024, Prokuroria Themelore përmes Aktvendimit [PP. nr. 2930/24], e hodhi poshtë kallëzimin penal të paraqitur nga Inspektorati Policor ndaj të dyshuarit B.RR, për shkak të dyshimit të kryerjes së veprës penale “Lëndim i lehtë trupor” i paraparë me paragrafin 1 të nenit 185 të KPRK-së, i ricilësuar nga Prokurori i Shtetit në veprën penale “Keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike”, i paraparë me paragrafin 1 të nenit 195, me arsyetimin se nga provat e administruara rezultoi se i njëjti kishte vepruar në përputhje me detyrat e tij dhe rrjedhimisht nuk ekziston dyshimi i arsyeshëm i kryerjes së veprës penale. Prokuroria Themelore arsyetoi se: *“Nga provat e administruara dhe deklarata e dëshmitarit si dhe raportet e Policisë së Kosovës rezultoi se i njëjti ka vepruar në përputhje me detyrat e tij dhe nuk i ka keqpërdorë autorizimet e tij. Provat e administruara tregojnë se i dyshuari nuk ka pasur për qëllim që të lëndojë, frikësoj apo ta fyej gazetaren por ka pasur për qëllim që t’i zbatoj detyrat e tij në drejtim të lirimit të rrugës dhe kalimit të lirë të Kryeministrit. Duke pasur parasysh se me asnjë provë nuk vërtetohet qëllimi i të dyshuarit që me anë të keqpërdorimit të autorizimeve të tij të lëndojë të dëmtuarën, frikësoj apo fyej dinjitetin e saj, Prokurori i Shtetit vjen në përfundim se nuk kemi të bëjmë në veprën penale, pasi veprat penale “Lëndim i lehtë trupor” dhe “Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike” janë vepra të cilat kryhen vetëm me dashje të drejtpërdrejtë, e në rastin konkret dashja e operatorit nuk ka qenë lëndimi i të dëmtuarës, mirëpo hapja e rrugës konform autorizimeve të tij në mënyrë që Kryeministri i vendit të kalojë i lirë dhe i papenguar sepse pozita e tij sipas deklaratimit të dëshmitarit vlerësohet si pozitë me rrezikshmëri të lartë”.*
21. Më 2 gusht 2024, parashtruesja e kërkesës kundër Aktvendimit [PP. nr. 2930/24], të 25 korrikut 2024, të Prokurorisë Themelore, paraqiti ankesë në Prokurorinë e Apelit, duke pretenduar se aktvendimi i kontestuar nuk është në përputhje me gjendjen faktike, është i përfshirë në zbatim të gabuar të dispozitave materiale të KPRK-së dhe si i tillë është i anshëm, i pabazuar dhe arbitrar.
22. Më 13 gusht 2024, Prokuroria e Apelit përmes Aktvendimit [AKAP. II. nr. 194/2024] refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtrueses së kërkesës, ndërsa vërtetoi aktvendimin e Prokurorisë Themelore, pasi konstatoi se në kallëzimin penal dhe nga provat e siguruara gjatë hetimeve preliminare nuk janë gjetur prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e arsyetuar se i dyshuari ka kryer veprën penale sipas denoncimit të dëmtuarës, dhe as veprën e ricilësuar penale të keqpërdorimit të ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike.
23. Prokuroria e Apelit arsyetoi se: *“[...] pretendimet e mësipërme ankimore në ankesën e palës së dëmtuarit, nuk janë të bazuara, meqenëse Prokuroria e shkallës së parë me marrjen e aktvendimit të atakuar për hedhjen e kallëzimit penal të parashtruar nga ankuesja, është kujdesur që të vlerësoj dhe në mënyrë të drejtë ka dhënë arsye të mjaftueshme, se në kallëzimin penal si dhe provat e siguruara gjatë hetimeve preliminare nuk janë gjetur prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e arsyeshëm, se e dyshuara ka kryer veprën penale për të cilën është paraqitur nga ana e të dëmtuarës, e as nga neni 195, par. 1 të KPRK-së, apo ndonjë veprë penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, ndërsa tani nuk ka argumente bindëse dhe nuk përmbajnë asnjërin prej bazave ligjore për të cilën mund të ngritët aktakuza, ashtu siç kërkohet me dispozitat e KPPK-së”.*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

24. Parashtruesja e kërkesës pretendon se vendimi i kontestuar ka shkelur të drejtat e saj të garantuara me nenet 27 [Ndalimi i Torturës, Trajtimit Mizor, Çnjerëzor ose Poshtërues], 32 [E drejta për mjete juridike] dhe 40 [Liria e Shprehjes] të Kushtetutës,

në ndërlidhje me nenet 3 (Ndalimi i Torturës), 10 (Liria e Shprehjes) dhe 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të KEDNJ-së.

25. Për më tepër, lidhur me vendimin e kontestuar të Prokurorisë së Apelit parashtruesja e kërkesës pretendon se “[...] *aktvendimi i atakuar nuk ka ofruar mbrojtje adekuate për parashtruesen e kërkesës. Pa një arsyetim adekuat, në mënyrë arbitrare, vendimi i atakuar ka konfirmuar aktvendimin e Prokurorisë Themelore në Prishtinë.*”
26. Parashtruesja e kërkesës thekson se ndaj vendimit të ankimuar nuk është lejuar ushtrimi i mjeteve juridike me arsyetimin se në rastin konkret refuzimi i ngritjes së aktakuzës, përkatësisht “*me lënien në fuqi të këtij aktvendimi, aktvendimi i atakuar në vend se të sigurohej që parashtrueses së kërkesës ti mbroheshin të drejtat së saj kushtetuese dhe ligjore, ka legjitimuar këto shkelje, duke krijuar, ndër të tjera, një standard të rrezikshëm për lirinë e gazetarëve në Kosovë.*”
27. Në kontekst të pretendimit të mungesës së mjetit juridik efektiv, parashtruesja e kërkesës i referohet nenit 84 të Kodit nr. 08/L-032 të Procedurës Penale, i cili parashihet se “*atakimi i vendimeve prokuroriale mund të bëhet vetëm brenda për brenda Prokurorit të Shtetit, përkatësisht Prokurorinë e Apelit, duke theksuar se ky mjet juridik nuk plotëson kriteret sipas nenit 32 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 13 të KEDNJ-së*”.
28. Më specifikisht, parashtruesja e kërkesës pretendon se “*Vendimi i atakuar jep një arsyetim të përgjithshëm, duke mos dhënë arsyetimet e kërkuara lidhur me secilin pretendim të ngritur nga parashtruesja e ankesës. Kështu, në rastin konkret, që të cilësohet si mjet juridik që plotëson kriteret e nenit 32 të Kushtetutës dhe nenit 13 të KEDNJ-së, ky mjet juridik nuk ka plotësuar haptazi kërkesat e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, ashtu siç është kërkuar nga jurisprudenca e GJEDNJ-së.*”
29. Parashtruesja e kërkesës në kuadër të shkeljes së nenit 27 të Kushtetutës, thekson faktin se “*trajtimi poshtëroes në rastin konkret vie nga një autoritet shtetëror, përkatësisht zyrtar policor, i cili ishte duke shërbyer si mbrojtje e afërt e Kryeministrit*”.
30. Lidhur me shkeljen e pretenduar të nenit 27 të Kushtetutës në lidhje me nenin 3 të KEDNJ-së, parashtruesja e kërkesës mbështetet në rastet e GJEDNJ-së: [Gafgen kundër Gjermanisë](#), [nr. 22978/05, Aktgjykim i 1 qershorit 2010], paragrafi 89; [Ilascu dhe të tjerët kundër Moldavisë dhe Rusisë](#) [nr. 48787/99, Aktgjykim i 8 korrikut 2004], paragrafi 425; dhe [M.S.S kundër Belgjikës dhe Greqisë](#), [nr. 30696/09, Aktgjykim i 21 janarit 2011], paragrafi 220, duke theksuar se: “[...] *trajtimi konsiderohet “degradues” kur ai poshtëron ose ul një individ, duke treguar mungesë respekti për të, ose duke e zvogëluar dinjitetin e tij ose të saj njerëzor, ose shkakton ndjenja frike, ankthi ose inferioriteti që mund të thyejnë qëndrueshmërinë morale dhe fizike të individit. Sipas GJEDNJ-së, mund të mjaftojë që viktima të poshtërohet në sytë e saj, edhe nëse nuk ndodh kështu në sytë e të tjerëve. Për më tepër, edhe pse pyetja nëse qëllimi i trajtimit ishte të poshtëronte ose të ulte viktimën është një faktor që duhet marr parasysh, mungesa e një qëllimi të tillë nuk mund ta përjashtojë përfundimisht gjetjen e një shkeljeje të nenit 3 [...]*”.
31. Më tej, parashtruesja e kërkesës po ashtu thekson se “*bazuar në jurisprudencën e GJEDNJ-së, kur një individ ka një kërkesë të diskutueshme se është torturuar nga agjentët e Shtetit, nocioni i një “mjeti efektiv” përfshin, përveç pagesës së dëmshpërblimit kur është e përshtatshme, një hetim i thellë dhe efektiv që mund të çojë në identifikimin dhe ndëshkimin e atyre që janë përgjegjës dhe që përfshin qasje efektive për ankuesin në procedurën hetimore*”.

32. Parashtruesja e kërkesës para Gjykatës në thelb pretendon se “Prokuroria Themelore kishte vendosur që të hedhë kallëzimin penal dhe mos të filloj fare hetimet”. Në këtë aspekt, parashtruesja e kërkesës shton se “në rastin konkret, një hetim i tillë nuk kishte ndodhur”.
33. Parashtruesja e kërkesës gjithashtu pretendon shkelje të nenit 40 (Liria e Shprehjes) të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 10 të KEDNJ-së, mbështetur në rastet e GJEDNJ-së Z. dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar, [nr. 29392/95, Aktgjykim i 10 majit 2001], paragrafi 73 dhe O’Keeffe kundër Irlandës, [nr. 35810/09, Aktgjykim i 28 janarit 2014], paragrafi 144, duke theksuar se: “në rastin konkret, parashtruesja ishte duke kryer detyrën e saj si gazetare, në një event të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, për përcjelljen e të cilit vet zyra e tij kishte ftuar mediat. Përmes dhunës së ushtruar ndaj saj, ajo nuk u lejua që të kryej punën e saj si gazetare. [...] Në këtë drejtim, përballë veprimit të kryer nga ana e zyrtarit policor, i cili veprim ka paraqitur trajtim poshtërues dhe cenim të lirisë së informimit, Prokuroria Themelore është dashur të veprojë në mënyrë adekuate për të mbrojtur, ndër të tjera, këto të drejta”.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 27

[Ndalimi i Torturës, Trajtimit Mizor, Çnjerëzor ose Poshtërues]

“Askush nuk i nënshtrohet torturës, ndëshkimit a trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues”.

Neni 32

[E Drejta për Mjete Juridike]

“Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj”.

Neni 40

[Liria e shprehjes]

“1. Liria e shprehjes është e garantuar. Liria e shprehjes përfshin të drejtën për të shprehur, për të shpërndarë dhe për të marrë informacione, mendime dhe mesazhe të tjera, pa u penguar nga askush. [...]”

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 3

(Ndalimi i torturës)

“Askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës ose dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese”.

Neni 10

(Liria e shprehjes)

“1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që t’u kërkojnë ndërmarrjeve të transmetimit audioviziv, televiziv ose kinematografik të pajisen me licencë.

2. Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t’u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor”.

Neni 13 (E drejta për zgjidhje efektive)

“Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare”.

KODI NR. 06/L-074 PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 185 (Lëndimi i lehtë trupor)

“1. Kushdo që personit tjetër i shkakton lëndim të lehtë trupor, i cili rezulton në:

- 1.1. dëmtimin e përkohshëm ose dobësimin e një organi apo pjese të trupit të personit tjetër;*
- 1.2. zvogëlimin e përkohshëm të aftësisë së personit tjetër për të punuar;*
- 1.3. shëmtimin e përkohshëm të personit tjetër; ose*
- 1.4. dëmtimin e përkohshëm të shëndetit të personit tjetër, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet. [...]”*

Neni 195 (Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike)

“1. Personi zyrtar, i cili duke keqpërdorur detyrën apo autorizimet e tij e keqtrajton, frikëson ose fyen rëndë dinjitetin e personit tjetër, dënohet me burgim deri në tre (3) vjet. [...]”

KODI NR. 08/L-032 I PROCEDURËS PENALE

Neni 84 Hedhja e kallëzimit penal

“[...]”

2. Prokurori i Shtetit e hedh kallëzimin penal nëse është e qartë nga kallëzimi se:

- 2.1. nuk ka dyshim të arsyeshëm se i dyshuari ka kryer veprën penale;*
- 2.2. vepra e kryer nuk është vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare ose sipas propozimit;*

- 2.3. ka arritur afati i parashkrimit të ndjekjes penale ose vepra penale është përfshirë në amnisti, falje, është gjykuar me vendim të formës së prerë, ose ekzistojnë rrethana të tjera që përjashtojnë ndjekjen penale ;
- 2.4. i dyshuari gëzon imunitet dhe heqja e tij nuk është e mundur ose nuk është miratuar nga organi kompetent; ose 2.5. ka rrethana që e përjashtojnë përgjegjësinë penale.
3. Para hedhjes së kallëzimit penal, Prokurori i Shtetit konsultohet me kryeprokurorin e prokurorisë përkatëse dhe mban shënim zyrtar.
4. Brenda tetë (8) ditësh nga hedhja e kallëzimit penal, Prokurori i Shtetit ia dërgon aktvendimin me arsyet për hedhjen e kallëzimit penal të dëmtuarit ose viktimës, personit apo organit që ka parashtruar kallëzimin penal. Aktvendimi për hedhjen e kallëzimit penal i dorëzohet edhe personit kundër të cilit është ngritur kallëzimi penal.
5. Në qoftë se Prokurori i Shtetit e ka hedhë poshtë kallëzimin penal, i dëmtuari ose viktimja mund të paraqesë ankesë kundër aktvendimit për hedhjen e kallëzimit penal brenda tetë (8) ditëve nga pranimi i njoftimit sipas paragrafit 4 të këtij neni. Ankesa paraqitet në Prokurorinë e Apelit përmes prokurorisë themelore. Ankesa duhet të përmbajë faktet dhe arsyet e ankesës.
6. Në qoftë se Prokuroria e Apelit vlerëson se ankesa është e bazuar, nxjerr aktvendim me të cilin e udhëzon Prokurorin e Shtetit për ndërmarrjen e veprimeve shtesë lidhur me kallëzimin penal. Parashtruesi i ankesës njoftohet nga Prokuroria e Apelit se ankesa i tij është aprovuar”.
7. Nëse Prokuroria e Apelit vlerëson se ankesa është pabazuar, me aktvendim të arsyetuar e refuzon ankesën dhe brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga momenti i parashtrimit të ankesës e njofton parashtruesin e ankesës. [...]”.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

34. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.
35. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcakton:
- “1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
[...]
7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.
36. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 47 (Kërkesa individuale), nenit 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe nenit 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47 (Kërkesa individuale)

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
(Afati)

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]”.

37. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se: (i) parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar në kuptim të paragrafit 7 të nenit 113 të Kushtetutës; (ii) ai konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin [AKAP. II. nr. 194/2024] të 13 gushtit 2024 të Prokurorisë së Apelit, përmes së cilit parashtruesja e kërkesës pretendon se i cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenin 27, 32 dhe 40 të Kushtetutës.
38. Në këtë aspekt, Gjykata thekson se përtej kriterit 4 (katër) mujor të përcaktuar në nenin 49 të Ligjit për parashtrimin e kërkesave para Gjykatës sipas procedurës të përcaktuar përmes paragrafit 7 të nenit 113 të Kushtetutës, përkatësisht kërkesave individuale, është gjithashtu pika (c) e paragrafit (1) të rregullit 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës, i cili përcakton si në vijim:

Rregulli 34
(Kriteret e pranueshmërisë)

(3) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të papranueshme nëse ndonjë nga kushtet në vijim është i pranishëm:

[...]

(b) kërkesa nuk është ratione materiae në pajtim me Kushtetutën;

[...].”

39. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se afati katër (4) mujor fillon të rrjedhë nga dita e vendimit të fundit në kuadër të procesit të shterimit të mjeteve juridike, përkatësisht nga data e marrjes së kopjes së vendimit (shih, rastin e Gjykatës, [KI144/22](#), me parashtruese *Sebahate Dervishi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 nëntorit 2022, paragrafi 52; dhe shih, rastin e GJEDNJ-së [Worm kundër Austrisë](#), kërkesa nr. 83/1996/702/894, Aktgjykim i 29 gushtit 1997, paragrafi 33).
40. Në këtë kontekst, në rrethanat e rastit konkret, Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës konteston Aktvendimin [AKAP. II. nr. 194/2024], e 13 gushtit 2024, të Prokurorisë së Apelit, ndërsa parashtruesja e kërkesës e ka dorëzuar kërkesën e saj në Gjykatë më 16 dhjetor 2024. Prandaj, në pamundësi të sigurimit të fletëkthesës e cila vërteton se kur parashtruesja e kërkesës e ka pranuar vendimin e kontestuar, Gjykata e konsideron kërkesën të dorëzuar brenda afatit të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit, pasi që i ka shteruar mjetet juridike, të përcaktuara me ligj, si dhe ka qartësuar të drejtat dhe liritë themelore të cilat pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit.
41. Fillimisht, Gjykata përsërit se objekt i kësaj çështje është kërkesa për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktvendimit [AKAP. II. nr. 194/2024], të 13 gushtit 2024, të

Prokurorisë së Apelit, përmes së cilit parashtruesja e kërkesës pretendon se i cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenin 27, 32 dhe 40 të Kushtetutës.

42. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit si dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ) në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
43. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se esenca e këtij rasti ndërlidhet me denoncimin e parashtrueses së kërkesës ndaj zyrtarit policor B.RR, në Inspektoratin e Policisë së Kosovës, me dyshimin e kryerjes së veprës penale *“Lëndimi i lehtë trupor, me ç’rast parashtruesja e kërkesës në cilësinë e gazetares, përgjatë tentimit të intervistimit të Kryeministrit ishte sulmuar nga mbrojtja e afërm e tij, respektivisht nga zyrtari policor B.RR. Si rrjedhojë, Inspektorati i Policisë paraqiti kallëzim penal në Prokurorinë Themelore, e cila fillimisht e ricilësoi veprën penale nga “Lëndimi i lehtë trupor” në veprën penale “Keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike”, dhe më pas përmes aktvendimit hodhi poshtë kallëzimin penal, me arsyetimin se nga provat e administruara nuk ekzistonte dyshimi i arsyeshëm se i njëjti ka kryer veprën penale. Kundër këtij aktvendimi, parashtruesja e kërkesës, parashtrroi ankesë në Prokurorinë e Apelit, duke pretenduar se aktvendimi i kontestuar nuk është në përputhje me gjendjen faktike, është i përfshirë në zbatim të gabuar të dispozitave materiale të KPRK-së dhe si i tillë është i anshëm, i pabazuar dhe arbitrar. Prokuroria e Apelit përmes aktvendimit, refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtrueses së kërkesës, ndërsa vërtetoi aktvendimin e Prokurorisë Themelore, pasi konstatoi se në kallëzimin penal dhe nga provat e siguruara gjatë hetimeve preliminare nuk janë gjetur prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e arsyetuar se i dyshuari ka kryer veprën penale sipas denoncimit të dëmtuarës, dhe as veprën e ricilësuar penale të keqpërdorimit të ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike, rrjedhimisht arsyetoi se nuk janë përmbushur kushtet ligjore të parapara me dispozitat e KPRK-së për ngritje të aktakuzës.*
44. Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës pretendon se vendimi i kontestuar ka shkelur të drejtat e saj të garantuara me nenet 27 [Ndalimi i Torturës, Trajtimin Mizor, Çnjerëzor ose Poshtërues], 32 [E drejta për mjete juridike] dhe 40 [Liria e Shprehjes] të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenet 3 (Ndalimi i Torturës), 10 (Liria e Shprehjes) dhe 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të KEDNJ-së.
45. Ndër të tjera, parashtruesja e kërkesës pretendon se vendimi i atakuar përmban arsyetim të përgjithshëm duke mos ofruar arsyetimet e kërkuara në pretendimet specifike të ngritura, si dhe ndaj refuzimit të ngritjes së aktakuzës, nuk është lejuar ushtrimi i mjeteve juridike duke arsyetuar se në rastin konkret të njëjtës i ka pamundësuar mbrojtjen e të drejtës së saj kushtetuese dhe ligjore, ndërsa në anën tjetër ka legjitimuar këto shkelje, duke krijuar, ndër të tjera, një standard të rrezikshëm për lirinë e gazetarëve në Kosovë.

Përkitazi me pretendimet për shkelje të neneve 27 [Ndalimi i Torturës, Trajtimin Mizor, Çnjerëzor ose Poshtërues], 40 [Liria e Shprehjes] të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenet 3 (Ndalimi i Torturës) dhe 10 (Liria e Shprehjes) të KEDNJ-së

46. Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës në kërkesën e saj specifikon shkeljen e neneve 27 [Ndalimi i Torturës, Trajtimin Mizor, Çnjerëzor ose Poshtërues], 40 [Liria e

Shprehjes] të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenet 3 (Ndalimi i Torturës) dhe 10 (Liria e Shprehjes) të KEDNJ-së.

47. Megjithatë, në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vlerëson se parashtruesja e kërkesës vetëm i përmend nenet e lartcekura ndërsa thelbi i ankesës së parashtrueses së kërkesës ndërlidhet me konstatimet e Prokurorisë Themelore dhe asaj të Apelit për hedhjen poshtë të kallëzimit penal ndaj personit të tretë, ndër të tjera, edhe si rezultat i mungesës së arsyetimit të Aktvendimit të kontestuar. Në këtë kuptim, Gjykata vëren se pretendimet e parashtrueses së kërkesës për hedhjen poshtë të kallëzimit penal ndaj personit të tretë, në thelb hyjnë në kuadër të pretendimeve lidhur me nenin 31 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
48. Në këtë aspekt, Gjykata në rastet e gjykuara para saj, çështjet që ndërlidhen me zhvillimin e procedurave penale kundër personave të tretë, i ka trajtuar në kontekst të pajtueshmërisë *ratione materiae* me Kushtetutën. Përkatësisht, Gjykata në të tilla raste ka konstatuar se pretendimet e parashtruesve të kërkesave që ndërlidhen me ndjekjen penale të personave të tretë nuk hyjnë në fushëveprimin e të drejtave civile të parashtruesit në kuadër të nenit 31 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Për më tepër, Gjykata po ashtu ka konstatuar se parashtruesve të kërkesës nuk iu garantohen mjete juridike për ndjekjen penale të personave të tretë. Në vijim të kësaj, Gjykata pretendimet e parashtrueses së kërkesës do t'i elaborojë dhe vlerësoj në kuadër të asaj nëse pretendimet e saj hyjnë në fushëveprimin e garantimit të të drejtave civile të parashtrueses së kërkesës.
49. Gjykata thekson që pajtueshmëria *ratione materiae* me Kushtetutën dhe KEDNJ-në e një kërkesë buron nga juridiksioni material i Gjykatës. Në mënyrë që një kërkesë të jetë e pajtueshme *ratione materiae* me Kushtetutën dhe KEDNJ-në, së cilës të drejtë i referohet parashtruesja e kërkesës duhet të jetë e garantuar dhe e mbrojtur me Kushtetutë dhe KEDNJ.
50. Në këtë kontekst, Gjykata i referohet praktikës së saj relevante gjyqësore e që ndërlidhet me rrethana në të cilat parashtruesit e kërkesës pretendojnë shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tyre të garantuara me Kushtetutë si rezultat i vendimeve të autoriteteve publike përkitazi me procedura penale kundër personave të tretë. Në rrethana të tilla, Gjykata duke u bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ), në harmoni me të cilën, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës është e detyruar që të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë, ka vendosur se kërkesat e tilla, në parim, nuk janë *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën, duke i shpallur rrjedhimisht si kërkesa të papranueshme (Këto raste përfshijnë por nuk janë të kufizuara në rastet e Gjykatës: shih, ndër tjerash, rastet e Gjykatës [KI52/18](#), me parashtrues Zoran Stanišić, Aktvendim për Papranueshmëri, i 16 janarit 2019, paragrafët 48-53; [KI15/21](#), me parashtrues Bersim Sulja, Aktvendim për Papranueshmëri, i 28 korrikut 2021, paragrafët 56-57; [KI174/18](#), me parashtrues Bedri Gashi, Aktvendim për Papranueshmëri, i 10 prillit 2019, paragrafi 31; dhe [KI77/20](#), me parashtrues Kujtim Zarari, Aktvendim për Papranueshmëri, i 11 nëntorit 2020, paragrafët 43-46, e të cilat janë të bazuara në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, duke përfshirë por mos u kufizuar në rastet [Istvanne Rekasi kundër Hungarisë](#), Vendim i 25 nëntorit 1996, e [Perez kundër Francës](#), Aktgjykim i 12 shtatorit 2004.
51. Arsyeshmëria e kësaj praktike gjyqësore ndërlidhet me interpretimin e nenit 6 të KEDNJ-së nga GJEDNJ, e që, për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, ndërlidhet me shprehjet “*për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij*” dhe “*të drejtat dhe obligimet*”, si pjesë përbërëse të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

52. Përkitazi me interpretimin e shprehjes "*për cilëndo akuzë penale*", e përfshirë në nenin 31 të Kushtetutës në dritën e nenit 6 të KEDNJ-së, GJEDNJ dhe Gjykata përmes praktikës së tyre gjyqësore kanë konstatuar se e njëjta nënkupton "*cilëndo akuzë penale të ngritur kundër parashtruesit të kërkesës*" (shih rastet e Gjykatës [KI52/18](#), parashtrues *Zoran Stanišić*, të cituar më lart, paragrafi 51; dhe [KI75/19](#), parashtrues *Naim Prokshi*, të cituar më lart, paragrafi 35).

53. Ndërsa, përkitazi me interpretimin e shprehjes "*të drejtat dhe obligimet*" të përfshirë në nenin 31 të Kushtetutës në dritën e nenit 6 të KEDNJ-së, GJEDNJ dhe Gjykata kanë konstatuar se e njëjta, për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, nuk nënkupton të drejtën për të ndjekur penalisht palët e treta, por se ushtrimi i kësaj të drejte në kontekst të rrethanave që ndërlidhet me një akuzë penale kundër një personi të tretë, nënkupton mundësinë e ushtrimit të një të drejte të viktimës në procedurë civile për të siguruar dëmshpërblim simbolik ose për të mbrojtur një të drejtë civile, duke përfshirë edhe ato që mund të ndërlidhen me reputacionin (shih, rastet e GJEDNJ-së [Perez kundër Francës](#), nr. 47287/99, Aktgjykim i 12 shkurtit 2004, paragrafët 70 dhe 71; [Rekić kundër Bosnje Hercegovinës](#), Vendim i 29 marsit 2018, paragrafi 24; dhe rastet e Gjykatës [KI97/14](#), parashtrues *Velibor Jokić*, Aktvendim për papranueshmëri, i 2 shkurtit 2015, paragrafi 36; [KI52/18](#), parashtrues *Zoran Stanišić*, të cituar më lart, paragrafi 50; [KI12/19](#), parashtrues *Arben Mërxha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 3 majit 2019, paragrafi 41; dhe [KI75/19](#), parashtrues *Naim Prokshi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 marsit 2020, paragrafi 37).

54. Duke iu rikthyer rrethanave të rastit konkret, Gjykata vë në dukje se çështja në fjalë ngërthen zhvillimin e një procedure penale kundër një pale të tretë, përkatësisht ndaj zyrtarit policor, dhe se procedurës së ndjekur nga Prokuroria Themelore, vërtetuar nga Prokuroria e Apelit, i kishte paraprirë: i) zhvillimi i hetimit disiplinor ndaj zyrtarit policor të denoncuar nga ana e Inspektoratit Policor, i cili përmes rekomandimit të raportit përfundimtar të hetimeve rezultoi se i njëjti kishte vepruar në përputhje me detyrat dhe specifikat e punës për mbrojtjen e afërt; ndërsa u pasua me ii) autorizimin e marrjes në pyetje të dëshmitarit të ngarkuar me detyrën për vlerësimin e sjelljeve të operatorëve të mbrojtjes së afërt, e cila sipas procesverbalit të deklarimeve rezultoi se veprimi i zyrtarit policor ka qenë konform rregullores dhe detyrave të punës së mbrojtjes së afërt; dhe iii) nxjerrjen e Vendimit për pushimin e procedurave disiplinore nga Inspektorati Policor pas konstatimit se i njëjti kishte vepruar në përputhje me detyrat dhe specifikat e punës së Departamentit për Mbrojtjen e Afërt.

55. Gjykata rithekson se rrethanat e rastit konkret, ngërthejnë pretendime për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të parashtrueses së kërkesës e të cilat ndërlidhen me rezultatet e procedurës penale, si pasojë e "*akuzës penale*" ndaj personave të tretë, të cilën Prokuroria e Apelit kishte vërtetuar Aktvendimin e Prokurorisë Themelore për hedhjen poshtë të kallëzimit penal.

56. Për më tepër, Gjykata vlerëson se në rrethanat e rastit konkret Vendimi i kontestuar, nuk prek të drejtat dhe detyrimet civile të parashtrueses së kërkesës. Ankesa e parashtrueses, në thelb, ka të bëjë me mosdënimin merititor të zyrtarit policor, çka nënkupton se të drejtat dhe detyrimet personale të parashtrueses së kërkesës nuk kanë qenë objekt shqyrtimi nga Prokuroria.

57. Prandaj, siç u sqarua më lart, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, dhe atë të Gjykatës, pretendimet e tilla të parashtrueses së kërkesës nuk hyjnë në fushëveprimin e nenit 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, dhe nuk janë *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën.

Përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 32 [E drejta për mjete juridike] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të KEDNJ-së

58. Përkitazi me pretendimin e parashtrueses së kërkesës lidhur me shkeljen e së drejtës për mjet juridik, përkatësisht shkelje të nenit 32 [E drejta për mjete juridike] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të KEDNJ-së. Gjykata rikujton se Prokuroria e Apelit përmes Aktvendimit [AKAP. II. nr. 194/2024] të 13 gushtit 2024, refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtrueses së kërkesës ndërsa vërtetoi aktvendimin e Prokurorisë Themelore, pasi konstatoi se në kallëzimin penal dhe nga provat e siguruar gjatë hetimeve preliminare nuk janë gjetur prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e arsyetuar se i dyshuari ka kryer veprën penale sipas denoncimit të dëmtuarës dhe as veprën e ri-cilësuar penale të keqpërdorimit të ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike.
59. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se sipas praktikës së GJEDNJ, megjithëse secili ka të drejtë për të përdorur mjetet juridike kundër vendimeve administrative dhe gjyqësore, KEDNJ nuk e garanton të drejtën e ankesës nëse atë nuk e parasheh legjislacioni vendor (shih, rastet e GJEDNJ [Yassar Hussain kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), kërkesa nr.8866/04, Aktgjykim i 7 Marsit 2006; paragrafi 26, dhe [Kudla kundër Polonisë](#), kërkesa nr. 30210/96, Aktgjykim i 26 tetorit 2000, paragrafi 151).
60. Për më tepër, siç përcaktohet në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, as neni 13 (E Drejta për Zgjidhje Efektive) e as ndonjë dispozitë tjetër e Konventës nuk i garanton një parashtruesi të kërkesës të drejtën për të siguruar ndjekjen penale dhe dënimin e një pale të tretë (shih rastet e GJEDNJ-së: [Roman Wilczynski kundër Polonisë](#), kërkesa nr. 35110/10, Vendim i 12 shtatorit 2017, paragrafi 28; dhe [Istvanne Rekasi kundër Hungarisë](#), kërkesa nr. 31506/96, Vendim i 25 nëntorit 1996) ose të drejtën për "hakmarrje private" (shih rastet e GJEDNJ-së: [Öneryıldız kundër Turqisë](#), kërkesa nr. 48939/99, Aktgjykim i 30 Nëntorit 2004, paragrafi 147; [Perez kundër Francës](#), kërkesa nr. 47287/99, Aktgjykim i 12 shkurtit 2004, paragrafi 70, dhe [Gorou kundër Greqisë](#), kërkesa nr.12686/03, Aktgjykim i 20 Marsit 2009, paragrafi 24).
61. Thënë këtë, Gjykata vëren se Kushtetuta dhe KEDNJ-ja nuk njohin të drejtën për ndjekje apo dënim të palëve të treta (shih [Perez kundër Francës](#), cituar më lartë, paragrafi 70) çka në të vërtetë, paraqet thelbin e kërkesës së parashtrueses sepse në rrethanat e rastit konkret e njëjta thjesht është e pakënaqur që përmes Vendimit të kontestuar nuk është ngritur kallëzimi penal.
62. Prandaj, duke qenë se në rastin konkret vendimi i kontestuar i Prokurorisë së Apelit nuk përcakton dhe as nuk prekë në asnjë mënyrë të drejtat dhe detyrimet civile të parashtrueses, kërkesa e saj dhe pretendimi i saj që ndërlidhet me mungesë të arsytimit të vendimit dhe mjeteve efektive juridike janë të papajtueshme *ratione materiae* me Kushtetutën.
63. Rrjedhimisht, kërkesa e parashtrueses së kërkesës ndërlidhur me pretendimet e lartcekura në kuptim të neneve 31 dhe 32 të Kushtetutës, ndërlidhur me nenin 6 të KEDNJ-së, duhet të shpallet e papranueshme në papajtueshmëri *ratione materiae* me Kushtetutën, ashtu siç përcaktohet me pikën (b) të paragrafit (3) të rregullit 34 të Rregullores së punës.
64. Si përfundim, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtrueses së kërkesës duhet të deklarohen në tërësi të papranueshme si *ratione materiae* të papajtueshme me

Kushtetutën, siç përcaktohet në pikën (b) të paragrafit (3) të rregullit 34 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe në pajtim me paragrafin (3) (b) të rregullit 34 si dhe pikën (b) të paragrafit (1) të rregullit 48 të Rregullores së punës, më 4 qershor 2025:

VENDOS


- I. TË DEKLAROJË njëzëri kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit; dhe
- IV. TË KONSTATOJË që ky aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari raportues


Radomir Laban



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese


Nexhmi Rexhepi